

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Biljana Rexhiq anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bujar Ahmeti, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.P., nga fshati ..., Komuna e Suharekës, për shkak të tri veprave penale Vjedhje, nga neni 325 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit av. B.M., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, P.nr.659/17, datë 12.02.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), më 28.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të të A.P. av. B.M., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, P.nr.659/17, datë 12.02.2018, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, me aktgjykimin P.nr.659/17, datë 12.02.2018, të akuzuarin A.P. e ka shpallur fajtor për shkak të tri veprave penale Vjedhje, nga neni 325 par. 1 të KPRK-së, për të cilat e ka dënuar veç e veç për secilën vepër, për veprat si në dispozitivin I, II dhe III të aktgjykimit me dënim me gjobë në shumë prej nga 100 (njëqind) € dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditësh, për secilën nga këto vepra penale, me ç'rast e ka gjykuar me dënim unik me burg efektiv prej 75 ditësh dhe dënim me gjobë në shumë prej 300€, të cilin dënim me gjobë duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e nëse e njëjta gjobë nuk mund të paguhet në afatin e paraparë, do t'i zëvendësohet me dënim me burg prej 15 ditësh, duke i llogaritur për 20€ të gjobës çdo ditë burgu. Është obliguar i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit taksën prej 30€. Pala e dëmtuar nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit av. B.M., dhe atë vetëm për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptoj dënim me kusht.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.356/2018, datë 17.04.2018, ka propozuar që të ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit konform dispozitave të nenit 390 të KPPK-së, mbajti seancën e kolegjit për të cilën me kohë dhe në mënyrë të rregullti njoftoj palët. Në seancë edhe pse të njoftuar me kohë, Prokurori i Apelit, të dëmtuarit H.H., B.S. dhe M.B., i akuzuari A.P. dhe mbrojtësi i tij av. B.M., nuk prezantoi asnjëra palë.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Në ankesë, lidhur me vendimin mbi dënim, mbrojtisi i të akuzuarit pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar mjaftueshëm faktin se i mbrojturi i tij veprën penale e ka kryer për shkak të varfërisë së skajshme, i njëjti e ka pranuar fajësinë, ka pasur sjellje korrekte, është penduar thellë për veprën e kryer, është i gjendjes së varfër ekonomike dhe i moshës së re. Gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh as faktin se të dëmtuarit i'a kanë falur gabimin të mbrojturit të tij, e as nuk i janë bashkëngjitur ndjekjes penale dhe nuk kanë kërkuar kompensim. Andaj mbrojtësi në ankesë, i propozon Gjykatës së Apelit që të ndryshohet aktgjykimi lidhur me sanksionin penal dhe të mbrojturit të tij t'i shqiptohet një dënim me kusht.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së. Si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë, ka pasur qëndrim korrekt ndaj gjykatës, është penduar për veprën e kryer, ka shprehur keqardhje për të dëmtuarit, është i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa si rrethana rënduese gjeti faktin se i akuzuari edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra të kësaj natyre. Andaj, në prani të këtyre rrethanave gjykata e shkallës së parë të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Një konstatim dhe vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe vlerëson se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe në pajtim me dispozitat ligjore. Në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit nuk ceken rrethana lehtësuese, të cilat nuk kanë qenë objekt vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë, andaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk ka vend shqiptimin e një dënimi tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, pastaj duke marrë për bazë mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, si dhe rrethanat tjera të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, e me qenë se në ankesë nuk ceket ndonjë rrethanë e re lehtësuese, e cila kishte me pas ndikim në shqiptimin e një dënimi më të butë, kjo gjykatë vlerëson se dënimi të cilin të akuzuarit i'a ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e posaçërisht duhet të jetë në funksion të preventivës gjenerale dhe individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.347/18, datë 28.05.2018

Zyrtari ligjor
Bujar Ahmeti

Kryetari i kolegjit
Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani
Biljana Rexhiq